

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6702
E shtunë, 10 shtator 2022
çmimi 0.40 €

Kosova dhe Mali i Zi
nënshkruajnë memorandum
bashkëpunimi
në fushën e mbrojtjes | **FAQE 3**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AVOKATI I THAÇIT: PROKURORIA PO VONON NISJEN E PROCESIT GJYQËSOR, TË REFUZOHEN DOKUMENTET SERBE



Fillimi i procesit gjyqësor ndaj Thaçit dhe të tjerëve po vonohet për shkak të prokurorisë e cila nuk po i ofron mbrojtjes të gjitha provat shfajësuese, thotë avokati i ish-presidentit Hashim Thaçi, Gregory Kehoe. Ai vlerëson se gjykata duhet t'i refuzojë dokumentet që Zyra e Prokurorit të Specializuar i merr nga Serbia, derisa thekson se e

kjo e fundit ka qenë historikisht e përfshirë në fabrikimin e dëshmimeve dhe dëshmitarëve. Në një intervistë për "KosovaPress", avokati Kehoe flet për stërzgjatjen e procesit ndaj ish-kreerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe, sipas tij, qëllimin e prokurorisë që ky gjykim të zgjasë më shumë se ai i Millosheviqit

AKTUALE



VDES MBRETËRESHA E BRITANISË F. 2

NAGAVCI THOTË SE PO PUNOJNË QË TA PËRMIRËSOJNË ARSIMIN NË VEND F. 7

RINOVOHEN NË SPITALIN E GJILANIT PULMOLOGJIA, LABORATORI I PATOLOGJISË DHE RADIOLOGJISË F. 6

EKONOMI



100 MIJË VIZITORË VIZITUAN 'HARDH FEST'-in F. 8

INFLACIONI NË MUAJIN GUSHT ARRIN NË 13 PËR QIND F. 8

SPORT



RIKTHEHET BASKETBOLLI F. 10



KURTI, EMISARËVE EVROPIANË: KOSOVA E ANGAZHUAR PËR DIALOG ME NJOHJE RECIPROKE

FAQE 7



KOZ-ja SHKATËRRON MATERIALIN E ZGJEDHJEVE LOKALE, RRETH 280 VENDVOTIME I RUAN PËR PROKURORINË

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vdes Mbretëresha e Britanisë

LONDËR, 9 SHTATOR - Mbretëresha Elizabeth II, monarkja më jetëgjatë në Mbretërinë e Bashkuar, ka vdekur të enjten në moshën 96 vjeçe. Familja e saj u mbledh në shtëpinë e saj në Balmoral të Skocisë, pasi iu përkeqësua gjendja shëndetësore.

Pallati mbretëror tha se "Mbretëresha vdiq paqësisht në Balmoral këtë pasdite".

Mbretëresha mori fronin në vitin 1952 dhe mbretëroi plot 70 vjet. Pas vdekjes së saj, fronin e merr djali i saj i madh, Charles, ish-Princ i Uellsit.

Përmes një deklaratë ai tha se vdekja e nënës së tij është një moment i madh trishtimi për të dhe familjen.

Mbreti i ri do të njihet zyrtarisht si Mbreti Charles III.

Kryeministrja e re e Britanisë, Liz Truss, tha se kombi duhet të bashkohet për ta mbështetur Mbretin. Ajo tha se vendi tani hyn në një epokë të re. "Ne i ofrojmë atij besnikërinë dhe përkushtimin tonë", tha ajo.

Gjatë mandatit Mbretëresha Elizabeth II ishte dëshmitare e kalimit të Perandorisë britanike në Komonuelth, e fundit të Luftës së Ftohtë dhe e hyrjes dhe pastaj daljes së Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Evropian.



Mbretërimi i saj pa 15 kryeministra, duke filluar nga Winston Churchill, i lindur më

1874, deri te Liz Truss, e lindur 101 vjet më vonë - më 1975, e cila mori mandatin në fillim të kësaj

jave.

Për shumë britanikë Mbretëresha Elizabeth përfaqësoi stabilitet në pjesën më të madhe të shekullit 20.

Përveçse për qasjen unifikuese, asaj iu dhanë merita për modernizimin e monarkisë dhe menaxhimin e disa skandaleve në familjen e saj.

Reagimet për vdekjen e saj filluan të vërshojnë nga e gjithë bota.

Shtëpia e Bardhë tha se Mbretëresha ishte një prej aleatëve më të fortë të Shteteve të Bashkuara. Presidenti Joe Biden dhe zonja e parë, Jill Biden, thanë se Mbretëresha "ishte më shumë se një monarke - ajo përkufizoi një epokë".

Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, tha se "ajo kurrë nuk dështoi të na tregojë rëndësinë e vlerave të

qëndrueshme në një botë moderne, me anë të shërbimit dhe përkushtimit të saj". "E kujtoj atë si një mike të Francës, një mbretëreshë zemërmirë, që ka lënë gjurmë të qëndrueshme në vendin dhe shekullin e saj", tha presidenti francez Emmanuel Macron.

Kryeministri belg Alexander De Croo tha se për më shumë se 70 vjet, Mbretëresha ishte "një fener stabiliteti dhe dinjiteti për popullin britanik".

Në Kosovë, presidentja Vjosa Osmani tha se "ajo ishte një udhëheqëse e vërtetë dhe një grua e jashtëzakonshme". "Përkushtimi, puna dhe përlësia e saj janë një frymëzim për të gjithë ne, veçanërisht në këto kohë të vështira", tha kryeministri i Kosovës, Albin Kurti.

Kalimi nga Mbretëresha në Mbret

Rregullat e monarkisë britanike thonë se "një udhëheqës i ri pason në fron sapo të vdesë paraardhësi i tij ose i saj". Kjo do të thotë se djali i madh i Mbretëreshës Elizabeth II, Princi Charles, u bë mbret menjëherë pas vdekjes së saj, më 8 shtator 2022. Brenda 24 orëve nga vdekja e një monarku, udhëheqësi i ri shpallet zyrtarisht sa më shpejt që të jetë e mundur nga "Këshilli i Anëtarësimit", në Pallatin e Shën James në Londër. Ky këshill përbëhet nga zyrtarë të Këshillit Privy, i cili përfshin ministra të lartë

të kabinetit, gjyqtarë dhe drejtues të Kishës së Anglisë, të cilët thirren në pallat.

Pas kësaj, Parlamenti mbledh ligvënësit ta bëjnë betimin e tyre për besnikëri ndaj monarkut të ri. Monarku i ri do të betohet para Këshillit Privy në Pallatin e Shën Jamesit për ta ruajtur Kishën e Skocisë, sipas Aktit të Bashkimit të 1707-s.

Shpallja e udhëheqësit të ri më pas lexohet publikisht në Pallatin e Shën Jamesit, si dhe në Edinburg, Kardif dhe Belfast, kryeqytetet e

katër kombeve që përbëjnë Mbretërinë e Bashkuar.

Charles duhet të deklarojë në Parlament, në ditën e parë të seancës së tij pas pranimit, ose të kurorëzimit, cilado që të jetë e para, se ai është një protestant besnik. Betimi është i mandatuar nga Akti i Deklaratës së Aderimit të vitit 1910. Ai, gjithashtu, duhet të bëjë një betim kurorëzimi siç parashikohet në Aktin e Betimit të Kurorëzimit të vitit 1689, Aktin e Zgjidhjes të vitit 1701 dhe Aktin e Deklaratës të Aderimit.

Guterres bën thirrje që bota ta ndihmojë Pakistanin

Nju-Jork, 9 shtator - Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, i ka bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar që ta ndihmojë Pakistanin, i cili po përballet me vërshime masive që kanë lënë të vdekur më shumë se 1 000 persona.

Si pasojë e vërshimeve, rreth një e treta e Pakistanit është nën ujë. "Kam arritur në Pakistan për ta shprehur solidaritetin tim të thellë me popullin pakistanez pas vërshimeve shkatërruese", ka shkruar Guterres në një postim në

"Twitter".

Guterres do të zhvillojë një vizitë dyditore në Pakistan. "Bëj thirrje për mbështetje masive nga komuniteti ndërkombëtar, teksa Pakistani po përballet me këtë katastrofë klimatike", ka shkruar Guterres.

Vërshimet, të shkaktuara nga reshjet masive të shiut përgjatë dy muajve, kanë lënë të vdekur të paktën 1 391 persona dhe kanë prekur 33 milionë banorë. Guterres pritet të takohet me kryeministrin pakistanez Shehbaz Sharif para se ta vizitojë provincën Sind, zonën

më të prekur nga vërshimet.

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka paralajmëruar për rrezikun e përhapjes së sëmundjeve për shkak se sistemi shëndetësor i Pakistanit është goditur nga vërshimet.

Javën e kaluar OKB-ja lëshoi një apel urgjent për të mbledhur 161 milionë dollarë për ta ndihmuar Pakistanin që të përballet me këtë katastrofë. Ministria e Financave e Pakistanit ka vlerësuar se dëmi i shkaktuar nga vërshimet në ekonomi deri më tani ka arritur të pakën 12 miliardë dollarë.



Kosova dhe Mali i Zi nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes

EPOKA
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur të premten në takim homologun nga Mali i Zi, ministrin Rasko Konjevic, me të cilin ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi në nivel të dy ministrive të mbrojtjes. Me këtë rast, ministri Mehaj ka theksuar se me nënshkrimin e këtij memorandum të bashkëpunimit, dëshmohet vazhdimësia e bashkëpunimit në mes të të dy vendeve, në nivele të tjera, me aktivitete dhe angazhime të përbashkëta.

Ministri Mehaj, në fjalën e tij drejtuar medieve, ka theksuar se nëpërmjet kësaj marrëveshje do të zgjerohet fushëveprimi i bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes që do të ketë ndikim të shumanshëm në të mirën e sigurisë, stabilitetit dhe demokracisë mes dy vendeve tona si dhe rajonit tonë në përgjithësi.



Më tej, ministri Mehaj ka thënë se thellimi në vazhdimësi i këtij bashkëpunimi do të mundësojë që lehtësisht të menaxhohet dhe me efektivitet të përballohen kërcënimet, rreziqet dhe sfidat në mjedisin e sigurisë rajonale, kontinentale e globale. “Mali i Zi, si shtet mik i yni, duke vlerësuar angazhimin e Republikës së Kosovës, Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së në mbështetje të

misionëve të NATO-s, do të ofrojë mbështetje edhe në procesin e realizimit të synimit tonë për anëtarësim në Programin e Partneritetin për Paqe si rrugë drejt anëtarësimit tonë në NATO”, ka theksuar ministri Mehaj në

konferencën për medie. Ndërsa ministri i Mbrojtjes i Malit të Zi, Rasko Konjevic, ka thënë se nëpërmjet këtij memorandum hapen rrugët për një bashkëpunim edhe më të mirë, duke theksuar se Mali i Zi do ta

përkrahë Kosovën për realizimin e aspiratave drejt integritetit euroatlantike. Bashkëpunimi në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi do të shtrihet që nga shkëmbimet e përvojave profesionale të kuadrove, qendrave akademike dhe specialistike dhe deri tek angazhimet në mbështetje reciproke me kapacitete operationale në rast të emergjencave.

KQZ-ja shkatërron materialin e zgjedhjeve lokale, rreth 280 vendvotime i ruan për Prokurorinë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Gati një vit pas zgjedhjeve lokale, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka filluar procesin e shkatërrimit të materialit zgjedhor, ku bëjnë pjesë edhe fletëvotimet dhe formularët e rezultateve. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka dhënë hollësi para medieve lidhur me këtë proces i paraparë në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Sipas tij, KQZ-ja do ta ruajë si provë materialin

zgjedhor të rreth 280 vendvotimeve për shkak të dyshimit për vepra penale kundër të drejtës së votimit. “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka filluar shkatërrimin e materialit zgjedhor të Zgjedhjeve Lokale që u mbajtën në tetor dhe nëntor të vitit 2021. Sipas vendimit të KQZ-së, pjesë të materialit që do të shkatërrohen janë fletëvotimet, formularët e rezultateve, listat e votuesve dhe të tjera. Marrë në përgjithësi, është planifikuar të shkatërrohet

materiali zgjedhor i më shumë se 2 200 vendvotimeve. Nga ky proces do të përjashtohet materiali zgjedhor i rreth 280 vendvotimeve dhe këtu përfshihen edhe materialet që i takojnë procesit të votimit me kusht dhe atij me postë”, ka thënë Elezi. Ai ka theksuar se këto materiale zgjedhore u takojnë komunave të ndryshme dhe do të ruhen si prova për qëllime të hetimit nga institucionet përkatëse shtetërore deri në përfundimin e të gjitha çështjeve.


Krasniqi: Kosova dhe Maqedonia e Veriut do ta vazhdojnë bashkëpunimin e shkëlqyer fqinjësor

Shkup, 9 shtator - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka nisur të premten një vizitë zyrtare në Maqedoninë e Veriut. Krasniqi është pritur në takim nga zëvendëskryeministri i parë, Artan Grubi, të cilin e ka uruar për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE dhe për rolin vendimtar të faktorit politik shqiptar në këtë proces.

“Rikthimi i vëmendjes së BE-së në Ballkanin Perëndimor, hapat konkretë të saj, janë lajm i mirë jo vetëm për Maqedoninë e Veriut, por edhe Kosovën e cila pret shpejt liberalizimin e vizave si një e drejtë e merituar tash e disa vjet. Bashkë diskutuam edhe për gjendjen e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, të cilët po dëshmojnë se janë përcaktues me kontributin e

tyre në secilin proces pozitiv institucional”, ka thënë Krasniqi. Lideri i PDK-së ka thënë se Kosova dhe Maqedonia e Veriut, sikur deri sot, do ta vazhdojnë bashkëpunimin e shkëlqyer fqinjësor, mirëkuptimin e ndërsjellë për përballimin e sfidave dhe proceset me interes të përbashkët. Krasniqi është takuar edhe me përfaqësues të tjerë të lartë të këtij shteti.





Avokati i Thaçit: Prokuroria po vonon nisjen e procesit gjyqësor, të refuzohen dokumentet serbe

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Fillimi i procesit gjyqësor ndaj Thaçit dhe të tjerëve po vonohet për shkak të prokurorisë e cila nuk po ia ofron mbrojtjes të gjitha provat shfajësuese, thotë avokati i ish-presidentit Hashim Thaçi, Gregory Kehoe. Ai vlerëson se gjykata duhet t'i refuzojë dokumentet që Zyra e Prokurorit të Specializuar i merr nga Serbia, ndërsa thekson se e kjo e fundit ka qenë historikisht e përfshirë në fabrikimin e dëshmimeve dhe dëshmitarëve.

Në një intervistë për "KosovaPress", avokati Kehoe flet për stërzgjatjen e procesit ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe, sipas tij, qëllimin e prokurorisë që ky gjykim të zgjasë më shumë se ai i Millosheviqit. Ai thotë se aktakuza është kundër UÇK-së dhe prokuroria po përpiket ta dokumentojë atë si një organizatë sekrete.

Kehoe fton bashkësinë ndërkombëtare që t'i kthejë sytë nga Gjykata Speciale dhe, siç thotë ai, të shohin se çka po ndodh aty. Ai, gjithashtu, konsideron se duhet të ketë vëmendje më të madhe të institucioneve dhe shoqërisë kosovare për proceset në Gjykatë Speciale.

Qytetarët e Kosovës nuk po e kanë të qartë pse procesi gjyqësor kundër krerëve të UÇK-së ende nuk po fillon?

Kehoe: Procesi nuk po fillon sepse Prokuroria nuk ka qenë e gatshme ta fillojë atë. Nëse ju kujtohet, në nëntor të vitit 2020 prokurori pati thënë se është i gatshëm ta fillojë gjyqin për gjashtë muaj. Kjo ndodhi para gati dy vjetëve qëkur ai e bëri këtë koment, dhe ende nuk është i gatshëm. Ata nuk kanë bërë gjithçka që duhet të bëjnë sipas rregullave, prandaj është vonuar.

A është mbrojtja gati të shkojë në proces gjyqësor?

Kehoe: Ne jemi të gatshëm t'ia fillojmë procesit porsa ata të na ofrojnë atë çka na takon ta kemi. Ata do të duhej të na ofronin të gjitha provat që do të prodhonin, të gjitha provat shfajësuese, por kjo nuk ka ndodhur.

Është thënë se gjyqi kundër krerëve të UÇK-së mund të zgjasë më shumë sesa gjyqi kundër Millosheviqit. Pse?

Kehoe: Kjo është një pyetje shumë e mirë. Nuk mendoj se kjo është një pyetje që dikush

nga ana e mbrojtjes mund t'i përgjigjet. Nuk duhet të jetë një gjyq që zgjat më shumë se gjyqi i Millosheviqit, por kjo është ajo që prokurori do të përpiket të bëjë. Kjo nënkupton, sipas meje, se ata do të shqyrtojnë çdo incident që ka ndodhur në Kosovë në vitin 1998 dhe 1999 dhe, sipas një teorie të "ndërmarrjes së përbashkët kriminale", t'i fajësojnë këta katër persona.

Pse prokuroria po fshihet dokumentet shfajësuese, listën e dëshmitarëve, po redakton materiale. A është kjo një strategji për ta zvarritur procesin gjyqësor?

Kehoe: Ata po thonë se po e bëjnë këtë për hir të sigurisë së dëshmitarëve. Ky është argumenti që ata po e përdorin. Megjithatë, duhet të ketë llogaridhënie, t'i thuhet mbrojtjes se çka do të thonë këta dëshmitarë dhe kush janë këta dëshmitarë. Kjo është ajo çfarë kërkova sot (të enjten) në gjykatë. Kjo është kyçe. Gjykata thotë se duhet bërë marrëveshje bazuar në ligj, por ne nuk mund të bëjmë marrëveshje pa i pasur këto prova.

Prokurori në seancën e së enjtes i krahasoi krerët e UÇK-së me kriminelët serbë. A mund të bëhet një krahasim i tillë?

Kehoe: Nuk ka krahasim! Ata po mundohen të dokumentojnë se UÇK-ja ishte një organizatë sekrete. Nuk ishte organizatë sekrete, ishte organizatë e cila luftoi për çlirimin e shqiptarëve të Kosovës. Ashtu është dhe ashtu gjithmonë ishte. Megjithatë, nëse e sheh aktakuzën, dhe nëse shikoni se çfarë kanë paraqitur, ata synojnë të thonë se UÇK-ja ishte një organizatë e përfshirë në aktivitete kriminale, e në fakt për çfarë ajo luftoi ishte çlirimi i shqiptarëve të Kosovës.

Përveç luftës juridike, a duhet Kosova të jetë proaktive edhe në diplomaci?

Kehoe: Në fund, duhet të fitosh në gjyq. Duhet ta prezantosh rastin në gjykatë - aty ku fitohet ose humbet. Ftoj të gjitha palët nga bashkësia ndërkombëtare të shikojnë se çka po ndodh në këtë gjykatë, dhe të pyesin veten nëse është e drejtë apo jo. Klienti im dhe tre të tjerët janë nën arrest që nga nëntori i vitit 2020, duke u thënë se gjykimi do të fillojë në gjashtë muaj. Kanë

kaluar gati dy vjet tashmë dhe me gjasë nuk do të kemi një gjykim në një të ardhme të afërt. Ftoj këdo të shoh se si po sillet kjo gjykatë dhe të pyetet nëse kjo është e drejtë apo jo.

A duhet gjykata t'i refuzojë dokumentet që vijnë nga Serbia?

Kehoe: Besoj se po. Qartazi, dokumentet e marra nga Serbia janë të diskutueshme. Çështja se Serbia ka qenë historikisht e përfshirë në fabrikimin e dëshmimeve dhe të dëshmitarëve, prandaj argumentet që ne i kemi ngritur janë se ne jemi të thirrur të dimë se prej nga vijnë këto dëshmi, dhe të pyesim kush i shkroi këto dokumente, kur janë shkruar ato, dhe si ju në Serbi patët kontroll në këto dokumente.

Prokuroria ka thënë se UÇK-ja ishte një akter sekret dhe joshitetëror. A mund të merret si një aktakuzë kundër të gjithë UÇK-së?

Kehoe: Natyrisht se po! Kjo është bile ajo çka argumentova të enjten në gjyq. Është një aktakuzë kundër tërë UÇK-së. UÇK-ja ishte një forcë që po përpiquej t'i çlirojë dhe mbrojtë shqiptarët e Kosovës nga ajo që

VIZITA E EMISARËVE EVROPIANË NË PRISHTINË, TË DËRGUAR NGA GJERMANIA
DHE FRANCA, SHTYTJE E RE PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI

Kurti, emisarëve evropianë: Kosova e angazhuar për dialog me njohje reciproke

I dërguari i Posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, nuk ka dhënë hollësi për takimin që ka pasur të premten në Prishtinë me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi. Pas takimit që Lajçaku ka mbajtur së bashku me këshilltarët e sapoemëruar të Gjermanisë dhe të Francës për këtë dialog, Jens Plettner dhe Emmanuel Beaune, ai ka thënë se patën një diskutim të rëndësishëm me Kurtin. Ndërkaq ky i fundit ka theksuar se Kosova ka treguar vullnetin dhe gatishmërinë për t'u angazhuar në "një dialog parimor me njohje reciproke"

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti ka pritur të premten në takim përfaqësuesin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak dhe këshilltarët për politikë të jashtme dhe siguri të kancelarit të Gjermanisë, Olaf Scholz dhe presidentit të Francës, Emmanuel Macron, Jens Plotner dhe Emmanuel Bonne.

Siç ka njoftuar Zyra për Informim e Kryeministrisë, në takim u theksua se Republika e Kosovës ka treguar vullnetin dhe

gatishmërinë për t'u angazhuar në një dialog parimor dhe të përgatitur mirë.

Kryeministri Kurti ka ritheksuar se qëllimi i dialogut nga i cili duhet të përfitojnë qytetarët e të dyja vendeve duhet të jetë arritja e një marrëveshjeje ligjërishit e obligueshme me njohjen reciproke në qendër. Ai e ka falënderuar Lajçakun si dhe këshilltarët Plotner dhe Bonne për angazhimin e tyre për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Gjatë takimit është biseduar për

nevojën e përpjekjeve edhe më të fuqishme nga të gjithë aktorët që perspektiva evropiane të bëhet realitet për shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Ndërkaq i dërguari i Posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, nuk ka dhënë hollësi për takimin me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi.

Pas takimit që Lajçaku ka mbajtur së bashku me këshilltarët e sapoemëruar të Gjermanisë dhe Francës për këtë dialog, Jens Plettner dhe Emmanuel Beaune, ai ka thënë

se patën një diskutim të rëndësishëm me Kurtin. "Ishte një diskutim i thellë dhe i rëndësishëm. Besoj e kuptoni se nuk mund të japim detaje, sepse do të kemi diskutim të njëjtë me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq", ka pohuar Lajçak.

Takimi i dy emisarëve së bashku me Lajçakun vjen pas propozimit në letërën e përbashkët të kancelarit Scholz dhe presidentit Macron drejtuar kryeministrin Kurti, që këshilltarët të bëjnë një vizitë të përbashkët me Mirosllav Lajçakun në Kosovë dhe Serbi në mënyrë që të gjejnë opsionet që procesi i dialogut të lëvizë përpara shpejt.

Më 31 korrik dhe 1 gusht tensionet janë rritur në veri të Kosovës, pasi serbët lokalë kanë kundërshtuar dy vendime të Qeverisë së Kosovës për targat dhe për dokumentet serbe.

Barrikadat e vendosura janë hequr pasditën e 1 gushtit, pasi Qeveria e Kosovës është zotuar se do ta shtyjë zbatimin e dy

vendimeve për një muaj. Por, pas ndërmjetësimit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara, Kosova dhe Serbia janë pajtuar që të heqin dorë nga lëshimi i dokumenteve për hyrje-dalje dhe më 1 shtator kjo marrëveshje nisi së zbatuari.

Po më 1 shtator në Kosovë ka nisur afati për reregjistrimin e veturave me targa serbe në ato RKS (Republika e Kosovës).

Të gjithë qytetarët që kanë makina me targa me akronime të Kosovës sikurse KM, PR, PZ e të ngjashme mund t'i reregistrojnë ato në RKS deri më 31 tetor.

Çështja e targave tashmë është kthyer në prioritet për bllokun evropian, i cili dëshiron të arrihet marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë para se të skadojë afati për reregjistrim.

Serbia kërkon që qytetarët në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe të përdorin targa KS - që kanë status neutral ndaj shtetësisë së Kosovës, por Kosova refuzon një propozim të tillë.



po bënin forcat serbe. Kjo është ajo çka bëjnë ata. Dhe kjo është pikërisht ajo çka ZPS po dëshiron ta cilësojë si të keqe. Nuk ishte ashtu! Ishte një ushtri çlirimtare!

Prokuroria ka thënë se viktimat kanë pritur 20 vjet për t'i treguar historitë e tyre në gjykatë. Si e vlerësoni ju këtë?

Kehoe: Është një propozim pa përkrahje nga faktet. EULEX-i, UNMIK-u, ICTY dhe gjykatat lokale në Prishtinë janë vendet ku disa nga këta dëshmitarë kanë dhënë dëshmi shtatë herë në shtatë procedura të ndryshme. Disa nga këto viktimat 4-5 herë. Pra, të thuash se ata kanë pritur për 20 vjet, nuk është absolutisht e vërtetë,

është jo e saktë. Gjithashtu, nuk ishte pse ata pritën për këta 4 të akuzuarit 20 vjet. Nuk është faji i tyre pse ZPS dhe DHS iu deshën 20 vjet për të ardhur deri këtu. Por, këta po e paguajnë një çmim, dhe po mbahen në burg për dy vjet tashmë, një vend i cili për mua nuk është i drejtë që këta të qëndrojnë aty, dhe nuk mendoj se asnjë person me

mendje objektive do të mendonte se është i drejtë.

A duhet një vëmendje më e madhe e institucioneve, e shoqërisë së Kosovës për atë çfarë po ndodh këtu në Hagë?

Kehoe: Absolutisht, sepse ky është një proces i Kosovës, dhe populli i Kosovës dëshiron të jetë i sigurt që ky proces të jetë i

drejtë. Kjo gjykatë është në Hagë, megjithatë është gjykatë e Kosovës. A dëshiron populli i Kosovës një gjykatë jo të drejtë dhe jotransparente dhe, me gjasë, të padrejtë? Sigurisht që jo! Prandaj, a duhet ata të interesohen të dinë se çfarë po ngjet këtu dhe si po shkojnë gjërat në këtë gjykatë? Natyrisht se po!

Rama: Po mendojmë të ndërtojmë rafineri të re për përpunimin e naftës

TIRANË, 9 SHTATOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, u shpreh të premten se Shqipëria e ka të pamundur të përpunojë naftë pasi ajo që prodhohet aktualisht është shumë e rëndë dhe jo për përdorim. Gjatë një takimi me dhomat e bizneseve, Rama zbuloi planet e qeverisë për të ndërtuar një rafineri të re të përpunimit të naftës. "Zgjidhja që kërkojmë është ndërtimi i një rafinerie të re, problemi është ku ta gjesh naftën që do ta përpunosh. Kjo pastaj është gjeopolitikë. Jemi në proces, nëse arrijmë kontratat e duhura, do të kalojmë në nivel tjetër ku mund të flasim për çmim me konkurrencë", ka thënë Rama. Në fund të vitit të kaluar, para krizës së energjisë, rafineria e fundit e përpunimit të naftës në Shqipëri u çmontua dhe përfundoi për skrap. Një bankë e nivelit të dytë e shiti rafinerinë e Ballshit për 9 milionë euro. Fillimisht, banka e nivelit të dytë

mësohet se ka negociuar për ta shitur rafinerinë për 25 milionë euro me qëllim që kompania blerëse ta rikthente atë në punë. Për këtë qëllim u ngritën dy grupe me ekspertë vlerësues të rafinerisë së amortizuar. Grupet e ekspertit, në bazë të vlerësimit, arritën në përfundimin se për ta rikthyer në punë rafinerinë, duheshin 30 deri në 50 milionë euro një kosto kjo shumë e lartë. Në këto kushte banka vendosi t'ia shesë rafinerinë kompanisë 'Shijaku shpk' për 9 milionë euro. Kompania 'Shijaku shpk' ka bërë më pas çmontimin e rafinerisë së Ballshit për ta çuar për skrap, sipas kontratës. Privatizimi dhe menaxhimi i rafinerisë së Ballshit ka qenë për vite me radhë mollë shëri midis opozitës dhe mazhorancës. Raportimet e shumta në medie kanë folur për korrupsionin dhe keqmenaxhimin e një prej rafinerive më të mëdha në Ballkan e cila në fund u la në mëshirën e fatit.



Rinovohen në Spitalin e Gjilanit Pulmologjia, Laboratori i Patologjisë dhe Radiologjisë

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, bashkë me ambasadorin e Luksemburgut në Kosovë, Eric Ditz dhe me drejtorin e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit, Arsim Emini, kanë përfunduar të premten reparatën e rinovuar të Pulmologjisë, Laboratorin e Patologjisë dhe pjesës së rinovuar të Radiologjisë në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit. Ky rinovim është bërë me ndihmën e Qeverisë së Luksemburgut. Në këtë përfundim morën pjesë edhe u.d. drejtoresha e ShSKUK-së, Pranvera Zejnullahu-Raçi, kryetarja e bordit të ShSKUK-së, Aida Rexhepi, anëtarja e bordit të ShSKUK-së, Agreta Gecaj-Gashi dhe kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni. Me këtë rast, ministri Latifi ka thënë se dita e sotme është një moment i rëndësishëm për zhvillimin dhe avancimin e shërbimeve shëndetësore në



komunën e Gjilanit, pasi që pacientët do të kenë kushte dhe shërbime më të mira për trajtimin e problemeve shëndetësore. "Ky monument është shumë i rëndësishëm edhe

për përmirësimin e kushteve të punës për mjekët, infermierët dhe stafin mbështetës, njëkohësisht edhe për shërbime sa më të mira për qytetarët e Gjilanit me rrethinë. E gjitha kjo

është në frymën e angazhimeve tona për transformimin e sistemit shëndetësor në vend", ka thënë ministri Latifi, duke falënderuar Qeverinë e Dukatës së Madhe të Luksemburgut, të

cilët financuan këtë projekt, që për rezultat do ta ketë avancimin e shërbimeve mjekësore, rritjen e sigurisë e cilësisë së shërbimeve për pacientit dhe ngritjen e motivimit për personelin shëndetësor.

Ky investim, tha ministri, dhe shumë investime të tjera që ka bërë Qeveria e Luksemburgut, si pjesë e aktiviteteve të projektit "Programi mbështetës për shëndetësinë në Kosovë KSV 017", tregon më së miri se bashkëpunimi i mirë që ka Kosova dhe institucionet e saj me Qeverinë e Luksemburgut, përkthehet në përfitime konkrete për qytetarët tanë. "Prandaj, sot nga ky vend u themi faleminderit taksapaguesve të Luksemburgut për mbështetjen e vazhdueshme, të cilën e vlerësojmë shumë dhe të cilën jam i bindur se do ta arsyetojmë me punë", ka pohuar ministri Latifi.

Ndalohe dy persona, u sekuestrohen drogë, 14 mijë euro dhe një veturë "Audi Q5"

PEJË, 9 SHTATOR - Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka njoftuar se në koordinim me Policinë e Kosovës, përkatësisht me Njësitin për Luftimin e Narkotikëve, ka ndaluar dy persona të dyshuar për veprën penale "Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge" nga neni 267 i Kodit

Penal të Republikës së Kosovës. Prokuroria ka njoftuar se si rezultat i veprimeve hetimore janë bastisur disa lokacione, ku gjatë kontrollit kanë gjetur dhe sekuestruar rreth dy kilogramë narkotikë të llojit marijuanë, janë sekuestruar rreth katërmëdhjetë mijë euro para kesh, një veturë e tipit "Audi Q5", një armë zjarri dhe telefonat e të pandehurve. Prokuroria Themelore e Pejës

brenda afatit ligjor do të parashtrijë kërkesë në gjykatën kompetente për shqiptimin e masës për sigurimin e prezencës të pandehurve në procedurë penale. Vlen të theksohet se gjatë kësaj jave, në tri raste të ndryshme, kjo prokurori, në koordinim me Policinë e Kosovës, ka ndaluar shtatë persona për shitjen, shpërndarjen dhe kultivimin e narkotikëve.



Nagavci thotë se po punojnë që ta përmirësojnë arsimin në vend

PODUJEVË, 9 SHTATOR - Ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka thënë se arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës është prioritet i kësaj qeverisje, ndërsa krahas politikave arsimore, ajo ka theksuar se po vazhdojnë ta përmirësojnë infrastrukturën shkollore gjithandëj duke e ditur rolin e rëndësishëm që ka ambienti shkollor në mësimdhënie dhe

mësimnxënie. "Si ministri jemi duke punuar me përkushtim të madh në shumë drejtime, në mënyrë që secila shkollë, secili mësues në Kosovë, të jetë i gatshëm dhe i motivuar për t'i ndihmuar secilit fëmijë që ta shfrytëzojë potencialin e tij të plotë", ka shkruar Nagavci në llogarinë e vet në "Facebook". Nagavci mori pjesë të enjten

në përrurimin e shkollës së re dhe sallës së edukatës fizike në Batllavë si dhe në vënien e gurthemelit të shkollës në fshatin Lluga të Podujevës. Ajo ka uruar mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe banorët e dy fshatrave dhe i ka njoftuar se po punojnë me një qasje shumëdimensionale që ta përmirësojnë arsimin në vend.



Hoti kërkon transparencë nga qeveria para dhe pas çdo raundi të dialogut

PRISHTINË, 9 shtator - Ish-kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka folur për vizitën e Jens Plettner dhe Emmanuel Beaune në Prishtinë, dy këshilltarëve të emëruar nga Gjermania dhe Franca për dialogun Kosovë - Serbi.

Hoti në "Facebook" ka shkruar LDK-ja është falënderuese për interesimin e shtuar të partnerëve kryesorë të Kosovës për ta përmbyllur marrëveshjen për normalizim dhe njohje reciproke në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. "Me këtë interesim të shtuar është e domosdoshme të sigurohet kohezioni i brendshëm politik dhe shoqëror për të mbështetur qeverinë në dialog për marrëveshjen finale, por paraprakisht duhet të sigurohet transparencë e plotë nga ana e qeverisë përmes raportimit në Kuvend, e cila gjë ka munguar pavarësisht prej rezolutës së Kuvendit ku i kërkohet

kryeministrit të raportojë para dhe pas çdo raundi të dialogut. Nuk ka forum tjetër për raportim përveç Kuvendit. Takimet me kryetarët e partive politike opozitare nuk e zëvendësojnë raportimin në Kuvend", ka deklaruar Hoti.

Ai ka thënë se kryeministri Kurti duhet të jetë i hapur në raportimin në Kuvend. "Ai nuk mund ta evitojë transparencën karshi deputetëve përmes deklaramëve për ndjeshmërinë e dialogut. Përtej kësaj, transparenca në dialog duhet të sigurohet edhe karshi komunitetit akademik, shoqërisë civile dhe medieve. Transparenca karshi tyre i mundëson qeverisë të marrë sugjerime të dobishme, në veçanti e ndihmon në informimin e publikut të gjerë për ta krijuar kohezionin e nevojshëm mbështetës për marrëveshjen finale", ka thënë Hoti.



MAPL-ja harton raportin 'Ndikimet socio-ekonomike të Covid-19 në komunat dhe bizneset e Kosovës'



PRISHTINË, 9 SHTATOR - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke parë nevojat dhe kërkesat e komunave gjatë përbaljes me pandeminë Covid-19, ka hartuar raportin "Ndikimet socio-ekonomike të Covid-19 në komunat dhe bizneset e Kosovës" në bashkëpunim me UN-Habitat. Ministri Krasniqi gjatë kësaj tryeze ka vlerësuar se ky raport është pjesë e planit strategjik operacional të MAPL-së, duke synuar mbështetjen ndaj komunave në përbaljen me pandeminë Covid-19.

Gjithashtu, ministri Krasniqi ka theksuar se përmes këtij raporti janë identifikuar dhe adresuar sfidat e komunave në përbalje me pandeminë Covid-19 dhe në bazë të këtyre të gjeturave inkurajohen komunat t'i hartojnë planin e rimëkëmbjes ekonomike lokale bazuar në udhërrëfyesin e hartuar nga MAPL. Në kuadër të këtij takimi, përveç përfaqësuesve të MAPL-së, morën pjesë edhe kryetarët e komunave, përfaqësues të komunave, aktorët ndërinstitucionalë dhe përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare.

24 500 seanca të dializës në Shërbimin e Dializës të Klinikës së Nefrologjisë

PRISHTINË, 9 shtator - Gjatë vizitës në Klinikën e Nefrologjisë, ushtruesja e detyrës e drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së, Pranvera Zejnullahu-Raçi, është njoftuar me punën që po bëhet në këtë klinikë dhe projektet që janë në zhvillim e sipër. Mimoza Ukimeraj,

drejtoreshë e Klinikës së Nefrologjisë, ka njoftuar se që nga fillimi i vitit deri më tani kanë trajtuar 665 pacientë me 24 500 seanca dialize.

Në fokus të bisedës ishte edhe projekti për funksionalizim të Dializës Peritoneale për të cilin u.d.

drejtoresha e ShSKUK-së ka premtuar mbështetje.

U diskutua edhe për zhvillimin e shërbimeve të reja, fillimin e trajtimit të sëmurëve me metodën ekstrakorporale të detoksifikimit - Plazmaferazë, por edhe trajnimi i stafit.



Inflacioni në muajin gusht arrin në 13 për qind

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) publikoi "Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit" (IHÇK) për muajin gusht 2022, ndërsa bëhet me dije se norma vjetore e inflacionit e matur në muajin gusht 2022, me muajin gusht 2021, ishte 13 për qind.

Inflacioni mujor i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit ishte 0.2 për qind në muajin gusht 2022. "Indeksi i tërësishëm i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0.2-përqindësh në muajin gusht 2022 krahasuar me muajin korrik 2022. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit të nëngrupit e COICOP-it: lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (6.3 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (3.6 për qind); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë

shtëpiake (2.3 për qind); mish (1.7 për qind); bukë dhe drithëra (0.6 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.6 për qind në IHÇK", thuhet në njoftim.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet e COICOP-it: karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (-6.1 për qind), me një ndikim prej (-0.4 për qind) në IHÇK.

Indeksi i Tërësishëm i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit është më i lartë në një mesatare prej 13-përqindësh në muajin gusht 2022 krahasuar me muajin gusht 2021. "Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të nëngrupit e COICOP-it: vajra dhe yndyra ushqimore (52.1 për qind); lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (48.6 për qind); bukë dhe drithëra (32.4 për qind); karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e



transportit personal (32 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (26.2 për qind); gaz (26.1 për qind); mish (22.5 për qind); sheqer, reçel, mjaltë, çokollata dhe ëmbëlsira (19.7 për qind); shërbime për transport (17.9 për qind); kafe, çaj dhe kakao (17.6 për qind); prodhime të ndryshme ushqimore, salca, erëza, kripë, ushqim për fëmijë etj. (15.7 për qind); shërbime

hoteliere (14.9 për qind). Mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (14.3 për qind); mirëmbajtje dhe rregullim i vendbanimit (12.2 për qind); vegla dhe pajisje për shtëpi dhe kopsht (11.3 për qind); kujdes personal (8.9 për qind); pushime të organizuara (7.9 për qind); ujë mineral, pije joalkoolike, lëngje nga pemët

dhe perimet (7.3 për qind); gjëra dhe pajisje të tjera rekreative, kopshte dhe manare (6.8 për qind); pjesë këmbimi dhe pajisje shtesë për pajisjet e transportit personal (6.2 për qind); gjëra personale (5.9 për qind); pajisje shtëpiake (5.4 për qind); blerje e automjeteve (5.3 për qind); duhan (5.3 për qind); pije alkoolike (5.2 për qind); produkte farmaceutike (4.6 për qind); qelqurina, takëme dhe mjetet e kuzhinës (4.2 për qind); mobilie dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dyshemeje (3.8 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 13.3 për qind në IHÇK", thuhet më tej.

Rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet i COICOP-it: pemë (-8.2 për qind); perime (-1.2 për qind); veshje (-0.7 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.3-përqindësh) në IHÇK.

100 mijë vizitorë vizituan 'Hardh Fest'-in



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Me një numër prej mbi 100 000 vizitorëve për tri ditë e tre net sa ka zgjatur festivali 'Hardh Fest', sivjet u shënua edicioni më i suksesshëm, me programin e pasur vreshtar, verëtar, trashëgimi kulturore dhe art që ishte përgatitur për vitin 2022.

Pjesëmarrja e vizitorëve në

'Hardh Fest' sivjet ishte dukshëm më e lartë se gjatë viteve të kaluara si me pjesëmarrje në aktivitetet e shumta unike dhe rekreative ditore të festivalit, po ashtu edhe në koncertet e tri netëve që sollën emra të njohur të skenës ndërkombëtare dhe vendore.

Vlen të përmendet edhe numri i rritur i pjesëmarrësve nga shtetet e rajonit dhe Evropa në edicionin e këtij viti.

Turistë të huaj iu bashkëngjitën në disa raste aktivitetet të ditës dhe u bënë pjesë e dhjetëra mijëra vizitorëve që morën pjesë në koncerte. "Pjesë e këtij suksesi janë të gjithë ata që kontribuuan, morën pjesë në aktivitetet ditore, që vizituan panairin e prodhimeve të verës, rakisë e rrushit në lokacionin e festivalit dhe ata që iu kënaqën tingujve të Pop & Rok me artistë të nivelit

botëror si Kip Winger. Organizatorët janë të kënaqur me të gjithë rrjedhën e ngjarjeve për tre ditët e kaluara dhe falënderojnë secilin vizitor e pjesëmarrës në aktivitetet si dhe institucionet, përkatësisht komunën e Rahovecit, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, partnerin 'StoneCastle', sponsorin gjeneral Banka për Biznes dhe

të gjithë sponsorët për mbështetjen e madhe për realizimin e kësaj ngjarjeje të rëndësishme kulturore për vendin", ka njoftuar 'Hardh Fest'.

'Hardh Fest' është një festival autentik që shkas organizimi merr festën e vjeljes së rrushit, duke promovuar kulturën e vreshtarisë dhe në përgjithësi bujqësinë lokale të Rahovecit përmes artit dhe trashëgimisë kulturore.

Qytetet nëntokësore në mbarë botën e lashtë, midis miteve dhe realitetit



Strukturat nëntokësore, dhe ndonjëherë edhe qytete të tëra, kanë qenë gjithmonë pjesë e miteve dhe besimeve fetare në mbarë botën. Ndërsa disa prej tyre janë zbuluar, shumica prej tyre jo. Krahas këtyre tregimeve për qytetet nëntokësore, ka edhe histori të tjera mbi rrjete dhe tunele nëntokësore që lidhin vende të ndryshme, apo edhe vendbanime të nëndheshme, të cilat ndonjëherë shtrihen për shumë kilometra.

Sipas traditave mitologjike anembanë globit, qytetet nëntokësore quheshin kryesisht si hyrje për në botën e nëndheshme. Atje shkonin zakonisht të vdekurit. Pak njerëz të gjallëlejoheshin ta vizitonin apo do të komunikonin me shpirtat e të vdekurve, Zotat, mbretërit apoushtritë e botës së nëndheshme. Por në disa raste, dhe sipas legjendave, ata mund ta ringjallnin edhe një të vdekur. Një nga qytetet më të famshme mitike nëntokësore është qyteti Agarta, që thuhet se ndodhet në qendër të Tokës, Bërthama e Tokës. Origjina e këtij miti është Azia Qendrore, dhe raca që banonte në këtë mbretëri nëntokësore u quajt Agarti.

Teozofistët i referohen Agartës si një kompleks i madh shpellash dhe një rrjet nëntokësor tunelesh

që banohej nga Asurat (demonët e këqij) dhe armiqtë e Perëndive. Ky rrjet nëntokësor supozohet se është krijuar nga njeriu. Në mitologjinë hindu, ka disa legjenda që flasin për një race të quajtur Nagas, krijesa inteligjente si gjarpërinj me fytyra njerëzore, që thuhet se jetojnë në shpella nëntokësore.

Ata përshkruhen si “fëmijë të Perëndive”, si të pavdekshëm dhe të aftë për të fluturuar, që u martuan me mbretër dhe mbretëresha njerëzore, dhe shumë të avancuar në aspektin shpirtëror. Po ashtu brenda shumë legjendave kineze, dragonjtë nuk ishin kafshët e shëmtuara fluturuese siç i njohim ne sot, por krijesa shumë të mençura që ishin këshilltarë të mbretërve.

Legjendat tibetiane flasin për njerëzit që hyjnë në shpellat e Naga-s. Thuhet se ato ishin pjesë e një rrjeti që gjarpëronte nën tokë për shumë kilometra brenda maleve të Azisë.

Ajo që është interesante në këto mite, është se një dritë e çuditshme buron në ato sfera nëntokësore si një lloj Dielli i brendshëm. Pra sipas përrallave mitike, qytetet e nëndheshme nuk janë të zhytura në errësirë. Disa nga këto vende të nëndheshme besohet se gjenden brenda Tokës, megjithëse në të

kaluarën ato ndodheshin në sipërfaqen e saj.

Legjendat thonë se ata u detyruan të zhvendosen nën tokë për shkak të rrethanave ekstreme si sulmet, apo ndoshta edhe ndryshimet klimatike. Shambhala (një fjalë sanskrite që do të thotë “vend paqeje”) është një tjetër vend i shenjtë i famshëm, që disa besime e konsiderojnë si një Parajsë shpirtërore.

Por të tjerë besojnë se Shambhala është një qytet i vërtetë nëntokësor, dhe gjatë historisë ka pasur histori mbi-njerëz që e kanë vizituar atë. Legjendat tregojnë se Mbreti i Shambhalas udhëtoi për në Indi për të takuar Budën, dhe për të dëgjuar mësimet e tij.

Një ndryshim i madh midis Agarta dhe Shambhala, është se i pari mbahet mend si një vend i demonëve, ndërsa Shambhala përshkruhet si një qytet i shenjtë. Spiritualistja e njohur Helena Blavacki, mendonte se Shambhala ndodhet në shkretëtirën e Gobit. Në anën tjetër të Tokës, kemi legjendën amerikane Akakor, që frymëzoi filmin aventuresk të vitit 2008 “Indiana Xhons dhe Kafka e Kristaltë”.

Në kronikën e Akakor, Tatunca Nara, një udhërrëfyes në xhunglën e Amazonës, pretendoi

se kishte parë qytetin, dhe përshkroi jo vetëm qytetin, por edhe kronikat e mbretërisë së nëndheshme. Sipas legjendave të Akakor, “Zotat” erdhën nga një sistem diellor i njohur si Shuerta, dhe ndërtuan një sistem tunelesh nëntokësore në Amerikën e Jugut. Ky qytetërim krijoi 13 qytete nëntokësore në Amerikën e Jugut në xhunglat e Amazonës, ku asnjëri prej tyre nuk është gjetur deri më tani. Ndërkohë në mitologjinë Maja kemi qytetin mitik nëntokësor Xibalba, “toka në të cilën perëndon Dielli”, e cila ishte e banuar nga superheronj dhe perëndi, një qytetërim që supozohet se u zhduk rreth Mesjetës.

Hyrja në këtë botë mendohej se ndodhej në Guatemalë, dhe përshkrimi i strukturave dhe vendndodhjeve brenda Xibalba-s përshkruhen në Popol Vuh, historia Quiche e krijimit tëbotës sipas Maya. Në Greqi, kemi mitet e Hadesit dhe botës së nëndheshme, një mbretëri ku jetonin perënditë dhe heronjtë. Brenda mitologjisë greke, Plutoni (Hadesi) ishte Zoti i botës së nëndheshme. Jeta e përtejme ishte e ndarë në seksione të ndryshme, Elizium dhe Tartarus. Legjendat norvegjeze flasin për xhuxhët, qenie të nëntokës që lidhen me mjeshtërinë në fusha të ndryshme. Racat e ndryshme

të xhuxhëve besohej se i furnizonin me armë Perënditë.

Edhe legjendat irlandeze flasin gjithashtu për botën e nëndheshme me historitë e tyre të njerëzve të quajtur Tuatha De Danaan (Njerëzit e perëndeshës Danu), një racë që u zhvendos nën tokë kur në ishull mbërriti një popull rival. Sot Tuatha De Danaan quhen fata.

Në Egjipt, historianët Herodoti dhe Straboni rrëfyan histori mbi një tempull të madhnëntokësor që përmbante 3000 dhoma plot me piktura dhe hieroglifë, një labirint i humbur që nuk është gjetur ende. Ndërkohë në kohët moderne, vazhdojnë të shtohen historitë e njerëzve që hyjnë në këtë mbretëri të nëndheshme.

Dëshmitë arkivore tregojnë se Hitleri dhe nazistët zbuluan në Antarktidë një hyrje për në qendër të Tokës. Nazistët i bënë jehonë pretendimeve për një qytetërim mbinjerëzor që jeton brenda Tokës. Edhe sot, disa njerëz vazhdojnë të besojnë se nazistët ishin në kontakt me ta, duke i drejtuar dhe madje duke ndarë me ta teknologjinë.

Ndërsa nuk ka asnjë provë të këtij lloji të kontaktit, ne e dimë se gjatë Luftës së Dytë Botërore, nazistët zotëronin teknologjinë më të avancuar, e cila shpesh e tejkaloonte atë të armiqve të tyre. / ancient origins – bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Fillon stinori evropian, Kastrioti luan në Bosnjë

Ferizaj, 9 shtator - Kastrioti i Ferizajt hap stinorin evropian për skuadrat e hendbollit. Hendbollistët e Kastriotit në kuadër të raundit të parë të Kupës Evropiane (EHF European Cup) luajnë me skuadrën nga Bosnjë-

Hercegovina, Graçanica. Për shkak të punimeve në palestrenë në Ferizaj, të dy ndeshjet do të luhen në Bosnjë-Hercegovinë, përkatësisht në qytetin Graçanica, në afërsi të Tuzllës. Ndeshja e parë është të shtunën prej orës 18:00, ndërsa e dyta të

dielën prej orës 18:00. Ferizajasi kanë udhëtuar me synime të mëdha për në Bosnjë. Në skuadër kanë ardhur lojtarë të rinj, përgatitjet kanë nisur me kohë dhe puna që po bëhet është serioze. Kastrioti ka shprehur pretendime të mëdha

për këtë edicion, ndërsa ndeshjet me skuadrën e suksesshme boshnjake do të jenë matës i mirë për nivelin e ferizajasve. Priten dy ndeshje të forta dhe cilësorë të Kastriotit, që në garat evropiane kthehet pas tri vjetësh.



Rikthehet basketbolli



PRISHTINË, 9 SHTATOR - Pritjes së gjatë i erdhi fundi. Në fundjavë do të fillojë Prince Caffè Superliga, që pritet të jetë shumë interesante. Tetë skuadrat janë konkurruese dhe kanë bërë përforsime të bujshme, me lojtarë vendorë dhe të huaj, ku priten shumë derbi gjatë gjithë edicionit. Kampioni aktual, Golden Eagle Ylli, do ta fillojë mbrojtjen e titullit me sfidën ndaj Rahovecit. Yllit i janë larguar Erjon Kastrati dhe Mikailë Imusiq, por ka bërë përforsime, ndërsa "Vreshtarët" janë organizuar dhe synojnë një edicion sa më pozitiv. Takimet ndërmjet këtyre dy skuadrave kanë qenë shumë interesante në vitet e fundit dhe kështu pritet edhe të shtunën në sfidën hapëse të kampionatit. Të shtunën do të zhvillohet përbalja në mes të Bashkimit dhe Vëllaznimit. Prizrenasit e nisin edicionin me synime të larta, kurse kuqezinjët janë rikthyer në elitë dhe nuk duan të largohen pas një viti. Derbi i kësaj xhiroje zhvillohet mes rivalëve të vjetër në basketbollin e Kosovës, Sigal Prishtinës dhe Pejës. Te "bardhekaltrit" u rikthye Dardan Berisha, pikërisht nga Peja, kurse "verdhezinjët" kanë rikthyer Alban Veselin dhe Artij Hajdarin. Të dyja

skuadrat, po ashtu, janë përforsuar me basketbollistë të huaj dhe pritet një superndeshje, siç ka qenë gjithmonë mes këtyre dy skuadrave. Ndeshja e fundit e kësaj xhiroje është ndërmjet Ponte Prizrenit dhe Trepçës. Prizrenasit edicionin e kaluar fituan Superkupën, që ishte trofeu i parë në histori të klubit dhe synojnë trofe edhe në këtë edicion, ndërsa mitrovicasit e nisin me synime të mëdha, ku do të luajnë në kualifikimet e FIBA Europe Cup, si dhe Superkupën Mbarëkombëtare, kurse synime të mëdha kanë edhe në garat vendore. Interesimi për basketboll është i madh dhe ky edicion po pritet të jetë i zjarrtë.

SUPERLIGA Java e parë

Të shtunën takohen:
17:00 Rahoveci - Golden Eagle Ylli
19:00 Bashkimi - Vëllaznimi

Të dielën takohen:
17:15 Sigal Prishtina - Peja
19:00 Trepça - Ponte Prizreni

Superliga me dy derbi

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Java e gjashtë e Superligës në futboll do të jetë interesante. Do të zhvillohen dy ndeshje derbi. Kampioni në fuqi i Kosovës, Ballkani, që po shkëlqen edhe në garat evropiane, këtë javë do të përballet me Dritën në Drenas, pasi stadiumi në Suharekë është duke u rinovuar. Ballkani është në vendin e dytë me 9 pikë dhe ka një ndeshje më pak të zhvilluar, derisa gjilanasit janë në pozitën e

tretë me tetë pikë. Xhiron e kaluar Ballkani e fitoi përbaljen me Prishtinën, derisa edhe Drita shijoi fitore në përbalje me Llapin. Të dielën zhvillohet edhe derbi tjetër në mes të Gjilanit dhe Prishtinës. Gjilani zë vendin e parë me 13 pikë, kurse kryeqytetasit janë në vendin e katërt me 7 pikë. Sot (e shtunë) do të zhvillohen dy ndeshje dhe takohen Malisheva - Dukagjini dhe Drenica - Trepça '89.

SUPERLIGA Java e gjashtë

Të shtunën takohen:
15:00 Malisheva - Dukagjini
15:00 Drenica - Trepça '89

Të dielën takohen:
15:00 Ferizaj - Llapi
15:00 Gjilani - Prishtina
15:00 Ballkani - Drita



Llapi ndan rrugët me portierin Kolaj

Podujevë, 9 shtator - Skuadra e Llapit ka njoftuar se ka shkëputur kontratën me portierin Agron Kolaj. Portieri i talentuar iu bashkua Llapit nga Besa e Pejës, por të premtën ka ardhur njoftimi nga klubi llapjan

se kontrata është ndërprerë me marrëveshje të dyanshme. Nuk janë dhënë detaje shtesë se pse ka ardhur deri te shkëputja e kontratës as nga klubi e as nga portieri 21-vjeçar. "Klubi i Futbollit Llapi njofton opinionin

se me marrëveshje të dyanshme ka ndërprerë bashkëpunimin me portierin Agron Kolaj. Klubi ynë dhe portieri Kolaj kishin marrëveshje të vlefshme për dy vitet e ardhshme, megjithatë vendosën ta ndërpresin

bashkëpunimin para kohe me marrëveshje të dyanshme. Kolajn e falënderojmë për angazhimin e deritanishëm si dhe i dëshirojmë shumë suksese në vazhdim të karrierës", thuhet në njoftimin e Llapit.



Swiatek - Jabeur, finalja e US Openit

NJU-JORK, 9 SHTATOR - Tenistja polake Iga Swiatek, numri një në botë dhe ajo tuniziane Ons Jabeur, numri pesë në botë, janë dy finalistet e grand slamit të US Openit për femra në tenis. Ato kanë triumfuar në gjysmëfinale dhe për herë

të parë do të ndeshen mes vete në një finale të madhe. Swiatek në gjysmëfinale e mposhti me rezultat 2-1 (3-6, 6-1, 6-4) bjellorusen Aryna Sabalenka. Një ndeshje që nisi keq për polaken, por që përmbysi gjithçka në favorin e

saj. Më e lehtë fitorja e Jabeur, që mundi pa shumë probleme 2-0 (6-1, 6-3) francezen Caroline Garcia. Swiatek është favorite, teksa ka fituar dy finalet e mëparshme në një grand slam ku është kualifikuar

(këtë vit ka fituar Roland Garros). Për Jabeur kjo është finalja e dytë radhazi në një grand slam, pas atij të humbur dy muaj më parë në Wimbledon. Ajo mund të bëhet afrikania e parë që fiton një grand slam.



'Nënshkrimi ose tradhtia e shekullit', zbulohet përpjekja e gruas për ta penguar kalimin e Figos te Real Madridi

LISBONË, 9 SHTATOR - Luis Figo ishte në vitin 2000 protagonist i një prej telenovelave më famëkeqe në historinë e futbollit. Portugezi ishte një pjesë themelore e Barcelonës, por ardhja e Florentino Perezit në presidencën e Real Madridit e bëri atë të marrë një vendim, që u përshkrua si tradhti e lartë.

Dokumentari "Rasti Figo: nënshkrimi i shekullit", i cili mund të shihet në Netflix, zhytet në këtë histori të tmerrshme, në të cilën shumë pretendojnë se kanë të vetmen të vërtetë. "Ka pasur shumë kërcënime, shumë presione, shumë deklarata dhe lajme të shëmtuara ndaj meje dhe familjes sime", ankohet Figo. Në atë kohë, ndërsa emri i tij dilte ditë për ditë në medie, portugezi u strehua në bregdetin idilik të Sardenjës me partneren dhe vajzat e tij. Por edhe atje nuk mund t'i shpëtonte shtypit apo rrethimit të ngushtë që përfaqësuesi i tij Jose Veiga dhe Paulo Futre i kishin vënë për ta bindur të largohej nga Barça. Një klauzolë e supozuar kontraktuale kërcënoi lojtarin, kështu që plani ishte të udhëtonte me aeroplan privat në Lisbonë për t'u takuar me Florentino Perez. Ato ishin ditë të tensionuara dhe gruaja e Luis Figo ishte "shumë e mërzitur



dhe e trishtuar", sipas dokumentarit. Por ajo që agjenti nuk priste ishte që Svedin do të ndalonte një përpjekje të fundit për ta bojkotuar transferimin, kur gjithçka dukej se ishte në rrugën e duhur.

Në Lisbonë, Florentino Perez i detajoi Figos projektin sportiv që kishte në mendje për Real Madridin, me të si gur themeli. "I thashë se lojtarët më të mirë në botë do të vinin, se ne donim ta bënim Real Madridin magjik dhe besnik ndaj historisë së tij. Për mua ai ishte shtylla mbi të cilën do të sillje ai projekt sportiv", shpjegon Perez. Në atë kohë, siç sqaron Futre, Figo ishte "pothuajse i bindur" për të nënshkruar me Real Madridin.

Por telefonata i mbërriti gruas së tij në agim dhe në atë që do të ishte një natë shumë e gjatë. "Po dëgjoja se çfarë thoshin të gjithë, deri në momentin që telefonova gruan time. I thashë: Shiko, kam marrë vendimin të shkoj te Real Madridi", thotë portugezi.

Ai i foli në anglisht, me shumë "po, po, po, po, po". Dhe kur mbaroi, erdhi "bomba": "Nuk mund të firmosësh atje". Ajo që Helen Svedin i tha atij më shumë në atë bisedë nuk dihet, por Florentino Perez ishte në gjendje ta ridrejtonte situatën në një mënyrë ose në një tjetër dhe rezultati dihet mirë: Figo u bë nënshkrimi i parë që prezantoi në "Santiago Bernabeu" si president i Real Madridit.

Ylli i NBA-s hedh në gjyq nënën: Markën time dua ta kontrolloj vetë

DALLAS, 9 SHTATOR - Luka Donçić vazhdon të dhurojë spektakël, por tashmë për kombëtaren slovene në Evropianin e Basketbollit që po zhvillohet në Gjermani, në të cilin ka shënuar 83 pikë në dy ndeshjet e fundit. Por ylli i Dallas Mavericks nuk e ka mendjen vetëm re basketbollit këtë javë, pasi ai e gjen veten në një mosmarrëveshje ligjore mbi kontrollin e markave tregtare që mbajnë emrin e tij. Gjëja më e habitshme është se në anën tjetër të "sherrit" është nëna e tij, Mirjam Poterbin, e cila nuk pranon t'i japë të drejtat sipas dëshirës. Gazetari amerikan Marc Stein ka siguruar se atleti ka paraqitur një peticion të martën e kaluar pranë



Zyrës së Patentave dhe Markave të Shteteve të Bashkuara (USPTO) për ta anuluar regjistrimin e "Luka Donçić 7". Sipas studios ligjore Brown Rudnick që përfaqëson Donçić, të drejtat aktualisht i takojnë nënës së tij dhe ky hap i

ndërmarrë nga sloveni është i fundit në një proces që tashmë ka akumuluar muaj më parë dhe me të cilin ai synon kontrollin e plotë të markave me emrin e tij. "Kam shumë për të prituri pasi vazhdoj të rritem si lojtar dhe si person dhe është e rëndësishme për mua ta kontrolloj markën time", ka thënë ai në një deklaratë për "The Stein Line".

Ylli i NBA-s synon ta fitojë kontrollin e plotë të emrit të tij, markës së tij, fondacionit dhe të gjitha çështjeve tregtare që lidhen me të, pasi statusi i markave kontradiktore e pengon atë të përfitojë nga një emër i njohur në të gjithë botën.

Wolverhamptoni rikthen Costën në Angli

Ish-futbollisti brazilian dhe spanjoll Diego Costa ka nënshkruar kontratë me Wolverhamptonin deri në qershor të vitit 2023, njoftoi klubi

anglez. Costa ka nënshkruar kontratën pasi ka marrë leje pune dhe ka kaluar një kontroll mjekësor. Në Wolverhampton ai do ta zëvendësojë

përfaqësuesin austriak Sasa Kalajdžić, i cili do të mungojë për disa muaj për shkak të lëndimit. Costa ka qenë jashtë fushës që nga janari, pasi kontrata e tij me

Atletico Mineira skadoi. Ai më parë ka luajtur për Atletico Madridin, Chelsea, Rayo Vallecanos, Valladolidit, Albacetes, Celtas, Bragës dhe

Penafielit. Për kombëtaren e Brazilit ka luajtur dy ndeshje, ndërsa për kombëtaren spanjolle ka luajtur në 24 ndeshje dhe ka shënuar 10 gola.

SHKURT

Nuk do të ketë Premierë Ligë këtë fundjavë

Me shumë mundësi Premierë Liga nuk do të zbrisë në fushë këtë fundjavë për shkak të ndarjes nga jeta të Mbretëresha Elizabeta II në moshën 96 vjeçe. Në Angli do të jetë një periudhë zie prej 10 ditësh, deri në funeral, teksa çdo ngjarje sportive, sipas protokollit zyrtar, do të shtyhet. Mungon ende vendimi zyrtar por, sipas medieve të mëdha, "Daily Mail" dhe "BBC", kampionati do të ndalet për ta respektuar Mbretëreshën. Këtë fundjavë në program ishte dhe ndeshja Manchester City - Tottenham, që me shumë mundësi do të shtyhet. Edhe sfidat e Kupës së Ligës dhe të kategorive të ndryshme do të shtyhen.

Atletico dhe Barcelona mund të përfundojnë në gjyq, shkak Griezmanni

Tensionet në mes të Barcelonës dhe Atletico Madridit janë rritur në orët e fundit dhe arsyeja quhet Antoine Griezmann. Siç raporton "Cadena SER", klubi blaugrana kërkon pagesën nga Los Colchoneros prej 40 milionë eurosh, në marrëveshjen që është bërë mes palëve në vitin 2021. Kushti për shlyerjen e këtij detyrimi financiar në fund të afatit dyvjeçar është zbuluar nga medieve. Sulmuesi duhet të luajë në 50 për qind të minutave të gjitha ndeshjeve. Sezonin e kaluar ai arriti në 81 %, ndërkohë që në sezonin aktual Atletico Madridi po tregohet shumë i kujdesshëm, duke e ulur ndjeshëm. Një sjellje që nuk i ka pëlqyer aspak Barcelonës, e cila mund ta hedhë në gjyq dhe çështja mund të marrë përmasa më të mëdha.

Mourinho: Humbje e pamerituar

AS Roma e nis me humbje këtë edicion të Ligës së Evropës. Ekipi i Jose Mourinhos u mposht në transfertë nga Ludogorets me rezultatin 2-1. "Rezultati ishte një gënjeshtër, të paktën kjo përshtypje m'u krijua. Nuk zhvilluam një ndeshje fantastike, por besoj se ishte mjaftueshëm për të fituar ose, të paktën, për të mos humbur. Për fat të mirë janë edhe pesë ndeshje në lojë", ka thënë Mourinho.

Formula 1 zhvendoset në Itali, Hamilton niset i penalizuar në Monza

Këtë fundjavë Formula 1 zhvendoset në Itali në një nga pistat më legjendare të kampionatit, Monza. Max Verstappeni do të kërkojë sërish suksesin për t'u afruar më tepër me titullin e dytë botëror, ndërsa pritet edhe reagimi i Ferrarit në pistën e shtëpisë. Nga ana tjetër, është edhe Mercedesi që së fundmi ka ardhur në rritje. Megjithatë, piloti i saj Lewis Hamilton niset i penalizuar pasi mekanikët e skuadrës gjermane kanë vendosur t'i ndryshojnë motorin makinës së shtatë herë kampionit të botës. Do të jetë motori i katërt nga tre të lejuar që Mercedesi ndryshon përgjatë sezonit në makinën e Hamiltonit dhe në këtë formë britaniku do të niset nga prapavija me një garë që duhet ta zhvillojë në malore. Megjithatë, Hamiltoni shpreson te forca e motorit të ri për të mbërritur të paktën një nga pesë vendet e para në Çmimin e Madh të Italisë.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LOKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 14-22

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fron të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:**

Dosja për: Kontratë për Auditim Funkcional dhe Financiar të OMK-së

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **16.09.2022 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **19.09.2022 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **19.09.2022 ora 15:00.**

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "International Logistic Corporation" - (ILC) Sh.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811442285 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "International Logistic Corporation" - (ILC) d.o.o., donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811442285 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that "International Logistic Corporation" - (ILC) L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 811442285, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Tahir Maliqi, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit "D.P.Z "LONI DESIGN" me NRB: 70823071.
- ▶ Haki Sylejmani B.I, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRF: 600606448.
- ▶ Merita Fejza, shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme "Dr. Xheladin Deda".
- ▶ Shpresa Dervishaj, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "SHOTE GALICA" në Runik-Skenderaj.
- ▶ Jeton Dervishi, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "SHOTE GALICA" në Runik -Skenderaj.
- ▶ Vlera Musa, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës se 9 të shkollës fillore "BEDRI GJINAJ".
- ▶ Valon Dervishi, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "SHOTE GOLICA" në Runik -Skenderaj.
- ▶ Arjanit Kuqi, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore të klasës: 6,7,8,9, "FAZLI GRAJQEVCI".
- ▶ Fatmir Kurteshi, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Ariktet Sinani".
- ▶ Fidane Tupella, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës shkolla e mesme "Hasan Prishtina".
- ▶ Emir Sylja, shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme "Hasan Prishtina".
- ▶ Erblina Kadriu, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 10-të shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".
- ▶ Erblin Haziri, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Shaban Idrizi".
- ▶ Azize Sylja, shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme të mjekësisë "Xheladin Deda".
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Musa Imeri, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme teknike "ARKITEKT SINANI".
- ▶ Flamur Vojvoda, shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHML: "DR XHELADIN DEDA"
- ▶ Arieta Rushiti, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "DR XHELADIN DEDA".
- ▶ Besnik Mziu, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit: NNP.SSB me NRB :70675692.
- ▶ Naser Gashi, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ekonomike "HASAN PRISHTINA". Burim Fazliu, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit "TEHNOHOME" SH.P.K. me NRB: 810549272.
- ▶ Besiana Brahimi, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ekonomike "HASAN PRISHTINA".
- ▶ Rafet Maxhuni, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ekonomike "HASAN PRISHTINA"
- ▶ Gani Thaçi, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit N.T.P "EBA" me NRB: 70724715.
- ▶ Genta Zejnullahu, shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën dhe certifikatën e testit te maturës, SHMLM "Xheladin Deda".
- ▶ Lumturie Havolli, shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e SHMLM "XHELADIN DEDA".
- ▶ Arza Feka, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës fillore "Ismail Qemajli".
- ▶ Behar Uka, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ekonomike "Hasan Prishtina".
- ▶ Valdrin Ferizi, shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10 dhe 11 të SHMLM "Dr. Xheladin Deda".
- ▶ Behxhet Hajrizi, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Lutfi Musiqi" ish-shkolla "Ali Kelmendi".
- ▶ Flamur Vojvoda B.I, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit "Morfodent" me NRB: 810571770.
- ▶ Limonita Behrami, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Fazli Grajqevci".



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 36 të Rregullores (ZKA) 02/2021 Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2022 (i ndryshuar/plotësuar), si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 1732 të datës 09.09.2022 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit ri shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Zyrtar për buxhet dhe financa
Numri i referencës:	RZBF/ZKA/18-09/22
Grada:	ZKA-C7
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon udhëheqësin e divizionit në organizimin e punës së përgjithshme, si dhe kujdeset për ndërmarrjen e veprimeve financiare të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të divizionit dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave;
- Përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve të domosdoshme për procesin buxhetor, kryen detyrën e zyrtarit zotues sipas LMFP-së;
- Menaxhon me parandësi dhe avanset për ZKA-në, dhe përkujdeset që para e imët përdoret në përputhje me procedurat ligjore në fuqi;
- Ndihmon në menaxhimin e sistemeve përkatëse të buxhetit (Sistemi për Menaxhimin dhe Zhvillimin e Buxhetit-SZHM dhe Programi për Investime Publike-PIP) me qëllim të realizimit të pagesave dhe raportimit financiar, si dhe mbështet mbikëqyrësin në përgatitjen e raporteve periodike për ecuritë buxhetore;
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Udhëheqësi i divizionit për Buxhet dhe Financa.

Kualifikimet Themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Dy (2) vite përvojë pune profesionale, preferohet përvojë të punës në planifikim dhe analiza.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në fushën e në fushën e buxhetit dhe financave;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit);

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Kompensimi i pagës për pozitën e shpallur bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, nga data 10.09.2022, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 25.09.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në receptionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova, članom 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (objavljeno u Službenom listu dana 16.09.2021); vezano sa članom 36 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji Radnih Mesta; Godišnjeg plana zapošljavanja za 2022. godinu (izmenjen/dopunjen), kao i Odluke Generalnog Revizora Br. 1732 datuma 09.09.2022, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Položaj:	Službenik za budžet i finansije;
Broj reference:	RZBF/ZKA/18-09/22
Nivo:	ZKA-C7
Broj radnih mesta:	Jedno (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže rukovodiocu divizije u organiziranju opšteg posla, kao i stara se o preduzimanju finansijskih radnji definisanih važećim zakonodavstvom;
- Izrađuje planove rada u skladu sa rukovodiocem za implementaciju zadataka definisanih na osnovu objektivna divizije i daje preporuke u pogledu ostvarivanja objektivna;
- Odgovoran za pripremu potrebnih dokumenata za budžetski proces, obavlja dužnost službenika za angažovanje prema ZUJFO;
- Upravlja sitnim novcem i avansima NKR-a, i osigurava da se sitni novac koristi u skladu sa važećim zakonskim procedurama;
- Pomaže u upravljanju relevantnim budžetskim sistemima (Sistem upravljanja i razvoja budžeta – SURB, i Programom javnih investicija-PJI) u cilju realizacije plaćanja i finansijskog izveštavanja, i podržava rukovodioca u pripremi periodičnih izveštaja o toku budžeta;
- Obavlja i druge zadatke po naređenju Rukovodilaca divizije za budžet i finansije.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva, poželjno radno iskustvo u planiranju i analizi.

Potrebne veštine:

- Znanje i iskustvo u oblasti budžeta i finansija;
- Veštine komunikacije i planiranja rada;
- Istraživačke, analitičke, evaluativne veštine i veštine formulisanja preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost ispunjavanja zadataka i rada pod pritiskom;
- Poznavanje rada na računarskim softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene položaje vrši se u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnosnažnom odlukom;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);


Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dostavljeni dokumenti nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, počevši od 10.09.2022 .godine, dok je rok za podnošenje dokumentacije 25.09.2022 godine do 16.00 časova.


Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručnju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kryetari i Komunës
Nr. 01-060-132847/22
Datë : 29.08.2022
Prizren



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi


Në bazë të nenit 11 paragraf. 1 dhe 4 lidhur me nenin 4 paragraf.1 dhe paragraf.2, 2.2., 2.3., 2.4. nën paragraf. 2.4.3.1. të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/ L-205 të datës 28 tetor 2010 të Republikës së Kosovës dhe nenit 44 dhe 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji Nr. 05/L – 031, merr :


VENDIM PËRFUNDIMTAR

- Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarit dhe zotëruesit të interesit, të cilat preken me realizimin e projektit për “Lirim dhe Qarkullimin e Rrugës së Transistit”, sipas tabelës që i është bashkangjitur këtij vendimi.
- Në bazë të vlerësimit të bërë nga ana e Ministrisë së Financave-Zyra për vlerësimin e pronave të paluajtshme, CAKTOHET lartësia e kompensimit për objektin e shpronësuar.
- Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Organi Shpronësues i dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara.
- Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Organi Shpronësues bënë shpalljen e Vendimit në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
- Kundër këtij Vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve në Gjykatën kompetente në Prizren, vetëm për shumën e kompensimit të përcaktuar në këtë Vendim, Subjekti kërkues cilito person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim si dhe çdo person i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekti i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelën e bashkangjitur të këtij Vendimi.
- Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike par dorëzimit të ankesës në Gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të i dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf Gjykata e refuzon ankesën.
- Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Organi shpronësues do të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë Vendim.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.


Vendimi u dërgohet :

Pronarit ose zotëruesit të interesit
Subjektit kërkues
Arkivi.

Organi Shpronësues :
Kryetari i Komunës

Shaqir Totaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
The Mayor
No. 01-060-132847/22
Date: 29.08.2022
Prizren



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi


Pursuant to Article 11 paragraph 1 and 4 in conjunction with Article 4 paragraph 1 and paragraph 2, subpar. 2.2., 2.3., 2.4. sub paragraphs 2.4.3.1. of the Law No. 03/L-139 on Expropriation of Immovable Property with Amendments and Supplementations made to Law no. 03/L-205 of 28 October 2010 of the Republic of Kosovo and Articles 44 and 45 of the Law on General Administrative Procedure, Law no. 05 /L - 031, renders :


FINAL DECISION

- The expropriation of immovable property on behalf of the public interest of owners and interest holders that are affected by the implementation of the project for the “Release and Circulation of the Transit Route”, according to the table attached to this decision, is approved.
- Based on the assessment made by the Ministry of Finance-Office for the Evaluation of Immovable Property, the amount of compensation for all expropriated properties is SET.
- Within 5 (five) business days of the issuance of this Decision, the Expropriation Authority shall deliver the Decision to the requesting entity and to other persons identified in the designated tables.
- Within 10 (ten) business days of the adoption of this Decision, the Expropriating Authority shall publish the Decision in the Official Gazette of the Republic of Kosovo and in a large circulation newspaper in Kosovo.
- Subjects are entitled to file an appeal against this Decision within 30 (thirty) days with the Competent Court in Prizren only for the amount of compensation set forth in this Decision, Claimant or any person who owns or holds an interest in immovable property or property rights affected by this Decision, as well as any person who has a legitimate direct and material interest in the immovable property which is the subject of the Final Decision, whether or not identified in the tables attached to this Decision.
- Within 5 (five) calendar days after submitting the appeal to the competent Court, the complainant shall ensure that 5 (five) copies of the complaint are physically submitted to the legal office of the concerned Expropriation Authority, if the complainant fails to comply with this paragraph, the court rejects the appeal.
- Within 2 (two) years from the date of entry into force of the Decision, the Expropriating Authority shall pay in full the amount of the Expropriation Compensation set forth in this Decision.
- This Decision shall enter into force on the date of its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo and in a newspaper of high circulation in Kosovo.


The decision is sent to:

Owner or holder of interest
The applicant
Archives

The Expropriation Authority:
The Mayor

Shaqir Totaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Predsednik Opštine
Br. 01- 060-132847/22
Dana: 29.08.2022
Prizren



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi


Na osnovu člana 11 paragraf. 1 i 4 u vezi sa članom 4 paragraf.1 i paragraf.2, pod paragraf. 2.2., 2.3., 2.4. pod paragraf. 2.4.3.1. Zakona br. 03/L-139 za Eksproprijaciju Nepokretnne Imovine sa izmenama i dopunama uradenim Zakonom Br. 03/ L-205 od dana 28 oktobra 2010 Republike Kosova i člana 44 i 45 Zakona za Procedure Opšte Administracije, Zakona Br. 05/L – 031, donosi:


ZAVRŠNA ODLUKA

- Usvaja se eksproprijacija za javni interes nepokretnih imovina vlasnika i nosioca interesa, koji se dotiču realizacijom projekta za „Oslobađanje i promet tranzitnog puta”, po tabeli koja je dostavljena ovom odlukom.
- Na osnovu procene urađene od strane Ministarstva za Finansije-Kancelarija za procenjivanje nepokretnne imovine, ODRÉDUJE SE visina nadoknade za eksproprijacioni objekat.
- U toku 5 (pet) radnih dana nakon donošenja ove Odluke, Eksproprijacioni organ šalje Odluku traženom subjektu i ostalim osobama identifikovanim na određenim tabelama.
- U toku 10 (deset) radnih dana nakon usvajanja ove Odluke, Eksproprijacioni Organ vrši objavljivanje Odluke u Službenim Novinama Republike Kosova i u jednoj novini sa najvećim tiražom na Kosovu.
- Protiv ove Odluke subjekti imaju pravo da podnesu žalbu u roku od 30 (trideset) dana nadležnom Sudu u Prizrenu, samo o iznosu nadoknade određenom ovom Odlukom, traženi subjekat-bilo koja osoba koja je vlasnik ili nosioc interesa na nepokretnu imovinu ili vlasnička prava dotaknuta ovom Odlukom, kao i svaka osoba koja ima jedan direktan legitiman interes i materijal na nepokretnoj imovini a koji je objekat Završne Odluke, nezavisno ako je identifikovan ili ne na dostavljenoj tabeli ove Odluke.
- U toku 5 (pet) kalendarskih dana nakon dostavljanja žalbe nadležnom Sudu podnosioc žalbe treba da osigura da se 5 (pet) kopije žalbe dostave fizički pravnoj kancelariji odgovarajućeg eksproprijacionog Organa, ako podnosioc žalbe ne deluje u skladu sa ovim paragrafom, žalba se odbija.
- U toku 2 (dve) godine od dana stupanja na snagu Odluke eksproprijacioni Organ će plaćati celokupan iznos nadoknade eksproprijacije, određen ovom Odlukom.
- Odluka stupa na snagu na dan objavljivanja u Službenim Novinama Republike Kosova i u jednim novinama sa najvećim tiražom na Kosovu.


Odluka se šalje:

Vlasniku ili nosiocu interesa
Podnosiocu zahteva
Arhivi

Eksproprijacioni organ :
Predsednik opštine

Shaqir Totaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Belediye Başkanı
No.01 – 060-132847/22
Tarih: 29.08.2022
Prizren



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi


Kosova Cumhuriyetin 03/L-205 sayılı 28 Ekim 2010 tarihli Yasa ile yapılan değişiklik ve tamamlamalar ile taşınımlaz malın kamulaştırılması ile ilişkin 03/L-139 sayılı Yasanın 11.maddesi 1. ve 4. fıkrası 4.maddesi 1. ve 2. fıkrası ve 2.2., 2.3., 2.4. alt fıkrası 2.4.3.1. alt fıkrası ve 05/L-031 sayılı İdari Süreç Yasasının 44.maddesi ve 45.maddesi gereğince işbu:

NİHAİ KARARI
alır

- İşbu Karara eklenen tabloya göre, “Transit yolun serbestleştirilmesi ve dolaşıma açılması” projenin gerçekleştirilmesi için mal ve çıkar sahiplerin gayrimenkul mülkiyetlerinin kamu çıkarı ile ilgili kamulaştırılması Onaylanmıştır.
- Maliye Bakanlığı-taşınımla malların değerlendirilme Dairesi tarafından yapılan değerlendirmeye göre kamulaştırılan binanın mülkiyeti ile ilgili tazminat miktarı BELİRLENİR.
- İşbu Kararın alınmasından 5 (beş) iş günü içerisinde, Kamulaştırma Makamı talep oluşumuna ve belirtilen tablolarda tespit edilen kişilere Kararı iletir.
- İşbu Karar onaylandıktan 10 (on) iş günü içerisinde, Kamulaştırma Makamı Kosova Cumhuriyeti Resmi gazetesinde ve Kosova’da büyük tirajlı bir gazetede Kararı ilan eder.
- İşbu Karara karşı oluşumların 30 (otuz) günlük zaman süresi içerisinde Prizren’de yetkili Mahkemesine, sadece işbu Karar ile belirtilen tazminat miktarıyla ilgili, talepci oluşum mülkiyet sahip veya taşınımla malda çıkar sahibi herhangi bir kişi veya işbu Karardan etkilenen mülkiyet hakkı olan, ayrıca doğrudan ve nihai Kararın objesi olan taşınımlaz malın maddi yasal çıkarı olan her kişi, işbu Karara eklenen tabloda tespit edilip edilmediğine bakmaksızın şikayet etme hakkına sahiptir.
- Yetkili Mahkemeye şikayet teslim edildiği günden 5 (beş) takvimsel gün içerisinde şikayet sunan yetkili Kamulaştırma Makamı yasal dairesine 5 (beş) adet şikayet kopyasını teslim etmelidir, eğer şikayet sunan işbu fıkrada yazanlara uymazsa şikayet Mahkeme tarafından reddedilir.
- Kararın yürürlüğe girdiği tarihten itibaren 2 (iki) yıl içerisinde Kamulaştırma Makamı, işbu Karar ile belirtilen kamulaştırma tazminat tutarın tamamını ödeyecektir.
- Karar, Kosova Cumhuriyeti Resmi gazetesinde ve Kosova’da büyük tirajlı bir gazetede ilan edildiği günden yürürlüğe girer.

Karar aşağıda yer alanlara iletilecektir:

Mal sahibi veya çıkar sahibi
Talepci oluşum
Arşiv

Kamulaştırma Makamı :
Belediye Başkanı

Shaqir Totaj



REPUBLICA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVO /GOVERNMENT OF KOSOVO
 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
 Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
 Departamenti i Tatimit në Pronë
 Departament za Poreza na Imovinu - Department of Property Tax

Komuna: Prizren Zona Kadastrale:Dushanove

Të dhënat sipas Elaboratit / Fletës Poseduese						Vlerësimi			
Nr.	Pronar	Numri i pronës	Kultura /Klasa	Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për Vlerësim m ²	Vlera e Pjesëve Aksesore (€)	Vlera për dru pyjor dhe frutor (€)	Vlera e Investimit (€)	Totali (€)
1	Pasuria Shoqërore-KK Prizren	425-2	Jo pjellore	2133	Vlera e Investimit; pjesët aksesor dhe dru pyjor dhe frutor				
Total				2133					

